

RRITJA E AUTONOMISE VENDORE NEPERMJET RENTAVE TE BURIMEVE

Rast studimor i bashkive Mirditë e Skrapar



Ky dokument u prodhuan si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja.

Përgatiti:

Xhanina Llango

Imeldi Sokoli

Rigerta Loku

Jetnor Kasmi

Nertil Bërdufi

HYRJE

Renta minerare apo e resurseve natyrore është një instrument i njohur gjërësisht në botë për impaktin që mund të ketë në zhvillimin ekonomik lokal apo rritjen e autonomisë financiare të nivelit vendor të pushtetit. Aktiviteti i nxjerrjes së mineraleve nga burimet natyrore është një kontribues i rëndësishëm në ekonominë shqiptare. Megjithatë, ajo sjell gjithashtu sfida thelbësore mjedisore dhe sociale, veçanërisht për komunitetet lokale në rajonet ku zhvillohet aktiviteti industrial. Aktualisht, të ardhurat që rrjedhin nga renta minerare kontrollohen pothuajse tërësisht nga qeveria qendrore, duke e lënë pushtetin vendor në zonat e pasura minerare me mbështetje financiare minimale për të zbutur efektet negative të industrisë nxjerrëse, të tilla si degradimi i mjedisit, zhvendosja dhe përjashtimi social. Kjo krijon pabarazi, pasi këto komunitete mbajnë peshën më të madhe të kostove të nxjerrjes, gjithashtu shohin pak përfitime drejt përmirësimit të shërbimeve publike apo zhvillimit ekonomik lokal të zonave ku ndodhin këto aktivitete minerare.

Ky çekuilibër midis vendit ku ndodh nxjerrja dhe vendit ku shpërndahen përfitimet krijon një nevojë të ngutshme për reformën e politikës së transfertës minerare. Rajonet e pasura me burime mbeten shpesh pa mjetet financiare për të trajtuar sfidat e shkaktuara nga nxjerrja, duke rezultuar në infrastrukturë të pazhvilluar, shërbime publike të dobëta dhe neglizhencë mjedisore.¹ Si rezultat, këto komunitete përjetojnë rritje të tensioneve sociale, duke thelluar më tej pabarazitë ekonomike midis rajoneve prodhuese të burimeve dhe pjesës tjetër të vendit.

Në mbarë botën, shumë vende të pasura me burime kanë pranuar nevojën për të rishpërndarë më në mënyrë më të barabartë të ardhurat e burimeve natyrore, duke siguruar që qeveritë lokale dhe komunitetet e prekura të marrin një pjesë të drejtë të të ardhurave të krijuara nga nxjerrja e pasurisë së tyre natyrore. Ky proces njihet si *ndarja e të ardhurave të burimeve natyrore*. Ajo përfshin ndarjen e të ardhurave nga burimet jo të ripërtëritshme, të tilla si mineralet, nafta dhe gazi, midis qeverisjes qendrore dhe vendore.² Qëllimi kryesor është kompensimi i rajoneve që mbartin kostot mjedisore dhe sociale të nxjerrjes dhe të sigurohet që këto të ardhura të përdoren për të nxitur zhvillimin e qendrueshëm lokal.

Në republikën e Shqipërisë sipas INSTAT, aktiviteti industrial/minerar kontribuon në rreth 13% të VSHB (vlerës së shtuar bruto) në nivel kombëtar një sektor i cili tregon potencialin që ka në ekonominë kombëtare, por ndërkohë të ardhurat nga taksat e këtij sektori përbëjnë vetëm 1.4% e nga PBB (Produktit të Brendshëm Bruto). Në vlera absolute spas Ministrisë së Financave renta minerare në vitet 2018-2023 varion në rënie nga 186.7 mln lekë në vitin 2018 në 157.9 mln lekë në vitin 2023. Kjo do të thotë që bashkive i shkojnë përherë e më pak fonde nga renta minerare, në këtë mënyrë bashkitë kanë mungesë më të madhe të burimeve të financimit në lidhje me përmirësimin e shërbimeve publike vendore. Këto vlera përbëjnë 5% të të ardhurave totale nga

¹ Narh, J. Mallkimi i burimeve dhe roli i institucioneve u rishqyrtuan. *Environ Dev Sustain* (2023). <https://doi.org/10.1007/s10668-023-04279-6>

² Copithorne, L., MacFadyen, A., & Bell, B. (1985). Ndarja e të ardhurave dhe vlerësimi efikas i burimeve natyrore. *Canadian Public Policy / Analyse de Politiques*, 11, 465-478. <https://doi.org/10.2307/3551076>

taksat e aktivitetit minerar që mblidhen në nivel qendror, kjo formulë në bazë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar t. Një ndarje më e barabartë ndërmjet pushtetit vendor dhe pushtetit qendror do të sillte ndikim të konsiderueshëm në autoniminë lokale/financiare të bashkive në rang vendi. Rishikimi i këtij raporti të transfertës së të ardhurave nga burimet natyrore do të sillte financime të shtuara të dedikuara për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm social dhe ekonomik në këto bashki.

Autonomia vendore është një indikator që përcakton pavarësinë dhe orientimin drejt interesave të zhvillimit të pushtetit vendor kundrejt atij qendror dhe në literaturë ky koncept vlerësohet si fuqia e vendimarrjes së lirë në përmbushjen e interesave të pushtetit vendor duke i siguruar këtij pushteti liri të mjaftueshme veprimi në menaxhimin e çështjeve publike lokale në të njëjtën kohë duke çliruar pushtetin qendror nga problematikat që lidhen ngushtësisht me komunitetet.³ Në këtë mënyrë krijohet mekanizmi i decentralizimit të kompetencave për zgjidhjen e problematikave nga autoritetet vendore.

Për të lidhur këto dy instrumente (**rentën minerare dhe autoniminë vendore**) janë përzgjedhur bashkitë e **Mirditës** dhe **Skraparit**, të cilat janë bashki me territore rurale të disfavorizuara nga pikëpamja e aksesit, e cila përkthehet edhe në ekonomi të pazhvilluar, ku rritja e rentës minerare apo taksimit të aktivitetin industrial do të sillte efekte mjaft pozitive në zhvillimin ekonomik lokal apo përmirësimin e shërbimeve publike. Në këtë kontekst Bashkitë e Mirditës dhe të Skraparit nga pikëpamja e aksesit të territorit janë ndër bashkitë më periferike në territor. Sipas studimit të Policentrizmit në Shqipëri zhvillohen 17 Zona Funktionale Urbane, ku Bashkia Skrapar ka një distancë mesatare prej 164.6 km ndërsa Bashkia Mirditë 249.2 km. Sa i përket distacës mesatare nga Bashkitë e Rajonit 3 (Qarqet Elbasan, Korçë, Berat) Bashkia Skrapar ka një distancë mesatare 104 km ose 184 minuta. Bashkia Mirditë në raport me bashkitë e Rajonit 1 (Qarqet Shkodër, Lezhë, Kukës) ka një distancë mesatare prej 126 km ose 102 minutash. Në raport me Njësitë Administrative të Bashkive Mirditë dhe Skrapar po ashtu vërehen zona periferike në raport me qendrat e qarqeve respektive ku NjA-të Zhepë, Gjerbës, Leshnje, Potom dhe Çepan të Bashkisë Skrapar variojnë në një distancë nga 121 deri në 190 minuta, ndërsa NjA-të Kthellë dhe Kaçinar të Bashkisë Mirditë variojnë në një distancë kohore 81 deri në 120 minuta në raport me qendrën e qarkut. Nga këto të dhëna të aksesit ndaj infrastrukturave vlerësohet se, bashkitë Skrapar dhe Mirditë hyjnë ndër bashkitë periferike dhe të largëta për t’u arritur në raport me qendrat urbane funksionale në nivel kombëtar e po ashtu në nivel rajonal. Ky periferialitet në akses ka dhënë rezultatet e tij edhe në ekonomi, duke zhvlerësuar ekonominë lokale në raport me zhvillimin ekonomik kombëtar, ku Qarku Lezhë (ku bën pjesë Bashkia Mirditë) ka një rënie në kontributin e PPB kombëtar nga 3.8% në 3.1% dhe Qarku Berat (ku bën pjesë Bashkia Skrapar) ka një rënie në kontributin e PBB kombëtar nga 5.2% në 3.6% në periudhën e viteve 2000-2018.

³ Keuffer, N. (2016, July). *Local autonomy, a multifaceted concept: How to define it, how to measure it, and how to create a comparative local autonomy index?* Paper presented at the International Congress of the International Political Science Association (IPSA), Poznań, Poland. Retrieved from https://www.researchgate.net/publication/331194391_Local_Autonomy_a_Multifaceted_Concept_How_to_define_it_How_to_Measure_it_and_How_to_Create_a_Comparative_Local_Autonomy_Index

Renta e burimeve natyrore dhe mekanizmi i transferimit pushtet qendror - pushtet vendor, shembuj nëpër botë VS rasti shqipëtar.

Ndarja e të ardhurave nga burimet natyrore është një instrument i njohur në mbarë botën për të siguruar që si qeveritë kombëtare, ashtu edhe ato lokale të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga pasuria e burimeve natyrore. Ky mekanizëm përfshin ndarjen e të ardhurave nga burimet jo të ripërtëritshme, të tilla si mineralet, nafta dhe gazi, midis qeverive qendrore dhe vendore.⁴ Qëllimi kryesor është kompensimi i rajoneve që mbartin kostot mjedisore dhe sociale të nxjerrjes dhe të sigurohet që këto të ardhura të përdoren për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm lokal. Ndarja e të ardhurave nga taksimi i burimeve natyrore nxjerrin në pah **tre modele kryesore të ndarjes së rentës**: 1) Shtete të cilat kanë transferte të njëjtë për zonat prodhuese dhe zonat jo prodhuese. 2) Shtete të cilat kanë transferte të ndryshme për zonat prodhuese dhe jo prodhuese që ndryshe quhen transferta me derivim. 3) Shtetet që kanë transferta të ndryshme për zonat prodhuese dhe jo prodhuese, por të mbështetura në indikatorë.

Për shembull, në deltën e lumit Niger të Nigerisë, të pasur me naftë, ku nxjerrja ka shkaktuar dëme të mëdha mjedisore dhe trazira sociale, qeveria zbatoi një sistem të ndarjes së të ardhurave bazuar në derivim, i cili ndan 13% të të ardhurave të naftës për rajonet prodhuese. Kjo politikë u hartua për të siguruar që rajonet që dëmtohen nga aktiviteti industrial të përtojnë nga prodhimi i naftës duke marrë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave për të investuar në projektet e zhvillimit, **për të përmirësuar infrastrukturën lokale dhe për të rivendosur shëndetin e mjedisit.**⁵ Ndërsa sfida të tilla si korrupsioni dhe keqmenaxhimi, sistemi përbën një përpjekje për të trajtuar drejtpërdrejt ankesat e komuniteteve të pasura me burime duke u siguruar atyre një pjesë më të madhe të pasurisë së nxjerrë nga tokat e tyre.

Në mënyrë të ngjashme, në Indonezi, qeveria qendrore u kthen qeverive lokale një pjesë të të ardhurave të naftës dhe gazit në zonat e nxjerrjes nëpërmjet një sistemi të bazuar në derivim. Kjo ka lejuar që rajonet e largëta dhe të pasura me burime të përmirësojnë kujdesin shëndetësor, arsimin dhe infrastrukturën, duke nxitur zhvillimin lokal në zonat që më parë ishin të margjinalizuara.⁶ Modeli i Indonezisë thekson se si mekanizmat e synuar të ndarjes së të ardhurave mund të ndihmojnë në transformimin e pasurisë së burimeve në mundësi zhvillimi lokal, duke përfituar drejtpërdrejt nga komunitetet më të prekura nga aktivitetet e nxjerrjes.

Në Mongoli, një sistem i bazuar në tregues është përdorur për të ndarë të ardhurat minerare si për rajonet prodhuese të burimeve, ashtu edhe për ato të pazhvilluara. Duke shpërndarë një pjesë të rentës minerare bazuar në faktorë si niveli i varfërisë, largësia dhe nevojat e infrastrukturës, qeveria

⁴ Copithorne, L., MacFadyen, A., & Bell, B. (1985). Ndarja e të ardhurave dhe vlerësimi efikas i burimeve natyrore. *Canadian Public Policy / Analyse de Politiques*, 11, 465-478. <https://doi.org/10.2307/3551076>

⁵ Bradford, D. F., & Oates, E. E. (1971). Analiza e ndarjes së të ardhurave në një qasje të re ndaj vendimeve fiskale kolektive. *Gazeta Tremujore e Ekonomisë*, 85(3), 416-439. <https://doi.org/10.2307/1885931>

⁶ Fedelino, A. (2010). *Making fiscal decentralization work: Cross-country experiences - Indonesia*. International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781589069855.084>

ka qenë në gjendje të drejtoj më shumë fonde në rajonet më të varfra, duke nxitur zhvillimin e balancuar kombëtar dhe duke reduktuar pabarazinë midis zonave urbane më të pasura dhe rajoneve rurale, të varura nga burimet.⁷

Këto shembuj ndërkombëtarë mund të jenë të vlefshëm për rastin shqipëtar, sepse rajonet e pasura me burime të Shqipërisë, si ato me depozita të rëndësishme minerare, shpesh janë ekonomikisht të pazhvilluara dhe përballen me sfida akute mjedisore apo ekonomike për shkak të aktiviteteve minerare. Megjithatë, pa një sistem të mirfilltë për ndarjen e transfertave minerare me këto rajone, qeveritë lokale mbeten pa kapacitetin financiar për të investuar në zhvillimin e qëndrueshëm, për të pakësuar dëmet mjedisore, apo për të përmirësuar kushtet e jetesës së popullsisë së tyre.⁸ Kjo ka rezultuar në pabarazi në rritje midis zonave të pasura me burime, por ekonomikisht të pafavorizuara dhe rajoneve më të pasura që nuk mbajnë kostot e drejtpërdrejta të nxjerrjes.⁹

Në rastin e bashkive në studim sipas INSTAT Bashkitë Skrapar dhe Mirëditë kanë një numër të lartë të familjeve që mbahen me te ardhura nga **ndihma sociale përkatësisht 24.4% dhe 33.5%**, po ashtu numër të lartë të familjeve me të ardhurave kryesore nga pensionet repsketivisht 34.6% dhe 39.6%. **Shkalla e papunësisë në Bashkinë Skrapar është 16.1% dhe tek te rinjtë është 27.8%** si dhe karakterizohet nga një numër shume i larte i **emigrimit me rreth 46.6%** të saj. Në bashkinë Mirditë shkalla e papunësisë është 44.2% dhe te ke të rinjtë 77.9% ndërkohë norma e emigrimit është 40.4%. Sa i përket detyrimit ligjor për të përmbushur rehabilitimin mjedisor rezulton se më pak se 1% e kompanive në nivel kombëtar e kanë përmbushur atë.

Në Shqipëri ky instrument rregullohet nga ligji nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar. Sipas këtij ligji 5 % e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Ndërkohë, në zbatim të udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, për transferimin e të ardhurave nga renta minerare te njësitë e vetëqeverisjes vendore ndiqet procedura si më poshtë vijon:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda datës 30 të çdo muaji, kryejnë rakordimin me Degët e Doganave/Drejtoritë Rajonale Tatimore, për rentën minerare të mbledhur nga subjektet taksapaguese, sipas udhëzimit. Degët e Doganave/Drejtoritë Rajonale Tatimore, brenda datës 30 të çdo muaji pasardhës, dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerën e rentës minerare të mbledhur, subjektin tatimor dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku kryhet aktiviteti. Ministria e Financave autorizon shpërndarjen e pjesës përkatëse të rentës minerare bazuar në akt-rakordimet e dërguara nga Degët e Doganave/Drejtoritë Rajonale Tatimore. Pas autorizimit nga Ministria e Financave, Drejtoritë Rajonale të Tatimeve dhe Degët e

⁷ National Resource Governance Institute. (2016, September). *Natural resource revenue sharing*. Local2030.

Retrieved November 19, 2024, from <https://www.local2030.org/library/221/Natural-Resource-Revenue-Sharing.pdf>

⁸ Velenturf, A. P. M., & Purnell, P. (2021). Principles for a sustainable circular economy. *Sustainable Production and Consumption*, 27, 1437–1457. <https://doi.org/10.1016/j.spc.2021.02.018>

⁹ Okpaleke, F. N., & Abraham-Dukuma, M. (2020). Dynamics of resource governance, climate change and security: Insights from Nigeria and Norway. *Journal of Strategic Security*, 13(4), 123-140. <https://www.jstor.org/stable/26965522>

Doganave paraqesin kërkesën për transferimin e fondit në degën përkatëse të thesarit. Dega e thesarit ku ndodhet drejtoria rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon, duke përdorur metodën e transferimeve të brendshme në sistemin e informatizuar financiar të qeverisë.

Nisur nga kategorizimi i mësipërm i sistemeve të transferimit të rentës, Shqipëria bën pjesë në kategorinë e transfertave të derivuara, por pa tregues duke bërë një diferencim nëpërmjet sasisë së prodhuar të mineralit në rajonet prodhuese. Nisur nga treguesit ku 95% e të ardhurave nga renta, i shkojnë nivelit qendor thotë se rajonet e pasura me burime shpesh janë të nënfinancuara dhe të paafta për të trajtuar ndikimet negative të nxjerrjes. Ky punim argumenton se Shqipëria do të përfitonte nga adoptimi i një qasjeje më të decentralizuar në transferimin e të ardhurave të burimeve. Ndarja e një pjesë të qirave minerale për qeveritë vendore në zonat e nxjerrjes dhe duke vendosur një formulë për shpërndarjen e të ardhurave në rajonet e pazhvilluara, **Shqipëria mund të zvogëlojë pabarazitë rajonale, të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurojë që komunitetet e ndikuara nga aktivitetet e nxjerrjes, të kompensohen në mënyrë të drejtë.**

Sektori i industrisë nxjerrëse në Shqipëri, Renta Minerare ndaj Bashkive si ndikon në autonominë vendore.

Sektori industrial luan një rol mjaft të rëndësishëm në ekonominë kombëtare të nga vlera e shtuar bruto e secilit sektor, vlerësohet se sektori industrial përmban rreth 14% të VSHB të përgjithshëm në nivel kombëtar dhe renditet si sektori i katërt më i rëndësishëm i ekonomisë pas sektorit Bujqësor, Tregtisë dhe Aktiviteteve Administrative. Gjithsesi industria nxjerrëse ka peshë krahasimisht të vogël me industrinë përpunuese sepse përgjithësisht mineralet nuk kryejnë të gjithë procesin industrial në Republikën e Shqipërisë.




Tabela 1: VSHB e sektorit industrial

Në nivel kombëtar egziston një potencial i madh për zhvillimin e këtij sektori ku sipas Agjensisë së Burimeve Natyrore ndodhen rreth **1,618 burime minerare** nga të cilat burimet e bakrit dhe kromit, janë dy mineralet që zënë përqindjen më të madhe të burimeve minerare me respektivisht, 187 burime bakri dhe 295 burime kromi ku shumica e këtyre burimeve ndodhën në pjesën Veri lindore-Jug lindore të Republikës së Shqipërisë, kryesisht në bashkitë Has, Tropojë, Fushë Arrëz, Mirëditë, Bulqizë, Klos, Dibër, Librazhd, Përrenjas dhe Pogradec.




Figura 1: Shpërndarja e burimeve minerare në Shqipëri sipas bashkive dhe sipas relievit.

Nga të dhënat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për lejet mjedisore në sektorin mineral, kemi një numër të përgjithshëm prej **574 lejesh mjedisore** me një sipërfaqe prej 364.7 km², që do të thotë që **më pak se 1/3 e këtyre burimeve minerare shfrytëzohen**. Ky fakt tregon nga njëra anë potencialin që ka sektori mineral por nga ana tjetër edhe peshën e ulët që ka në PBB e cila varjon nga 0.25% në 1.2% e saj. Vlerësohet se rreth **25% e bashkive të Shqipërisë** kanë në territoret e tyre pasuri të mëdha kombëtare, ndërkohë sipas INSTAT këto bashki paraqesin normat më të lartë të papunësisë, varfërisë apo peshë shumë të ulët në PPB (PPB sipas qarkut).

Në rang bashkish, sa i përket numrit të burimeve minerare Bashkia Tropojë zë vendin e parë në republikë, më pas vjen Bashkia Mirditë me rreth 129 burime, ndërkohë Bashkia Skrapar renditet e 44 me rreth 9 burime minerare.

Nga ana tjetër në rang kombëtar transferta e përgjithshme nga pushteti qendror në atë vendor në kuadër të rentës minerare varion nga 112.1 mln lekë në 234.8 mln lekë e cila është vetëm 5% e totalit të të ardhurave kombëtar nga taksimi i aktivitetit mineral gjë që vlerësohet si një indikator mjaft i ulët në krahasim me nevojën që kanë këto bashki për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike dhe ekonomisë lokale. Kjo transfertë bashkohet me dy të ardhura të tjera që kanë të bëjnë me tatimin mbi të ardhurat personale dhe taksa e regjistrimit të automjeteve të cilat formulojnë trasfertën nga taksat e ndara e cila u vjen bashkive nga pushteti qendror.

Sa i përket autonomisë fiskale të pushtetit qendror kundrejt vendorit, **balancimi më i mirë i këtij instrumenti do të rriste autonominë fiskale, si një ndër indikatorët kryesor për performancën e bashkive dhe mundësinë për të përmirësuar jetën e banorëve në territoret e**

tyre.

Në nivel kombëtar struktura e shpenzimeve publike në nivel vendor është e ndarë në mënyrë të tillë që 50.6% e shpenzimeve publike vendore kanë si burim të ardhurat e veta, rreth 48.6% kanë si burim të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe 0.8% kanë si burim financime të huaja. Nga njëra anë bashkitë duhet të synojnë rritjen në mënyrë progresive të të ardhurave të veta, në mënyrë që të kemi më shumë pavarësi në zbutjen e problematikave, por nga ana tjetër edhe niveli qendor duhet të rrisë ndjeshëm transfertën ndërqeveritare sepse ky indikator zë një peshë të papërfillshme në PBB. Në këtë tregues mesatarja e BE sipas OECD është 5.53% e PBB, ndërsa për Shqipërinë ky indikator varion nga 1% deri në 1.5% e PBB. Po ashtu Shqipëria ka një raport mjaft të ulët të shpenzimeve vendore ndaj PBB i cili përlllogaritet në rreth 3% ndërsa mesatarja e BE është rreth 18.4%. Në këtë kuadër, një kontributor i qënësishëm i rritjes së këtij indikatori do të ishte transferata.¹⁰

Tarifimi nga pushteti vendor i aktivitetit i prodhimit energjistik të hidrocentraleve

Shembulli i Republikës Popullore të Kinës në ndarjen e transfertave për të ardhurat nga shfrytëzimi i burimeve natyrore, jep një shembull specifik se si mund të zhvillohet ky instrument në kuadër të industrisë energjitike, e cila luan një rol kryesor në PBB-në e vendit duke u bërë kështu edhe prodhuesi kryesor i energjisë elektrike në botë me 19.1% të prodhimit botëror të energjisë.¹¹ Sa i përket këtij sektori, Kina ka një sistem të komplikuar taksash për shfrytëzimin e burimeve natyrore, të cilat ndahen në taksa kombëtare, taksa lokale dhe taksa të përbashkëta, por gjithsesi ky rast zhvillon dy instrumente të tilla si taksa e gjermimit dhe e nxjerrjes, e cila ndahet 60% në nivel kombëtar dhe 40% në nivel vendor si dhe taksa e kompensimit, e cila ndahet 50% -50% ndërmjet nivelit qendror dhe vendor.¹²

Ndërkohë në kontekstin europian Agjencia Europiane e Mjedisit e konsideron prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet si një burim energjie, jo te rinovueshëm dhe jo të pasër sepse ndërtimi i HEC-eve ka efekte të pakthyeshme në territor, në mjedis si dhe në florën dhe faunën e zonës ku ndërtohet. Si i tillë ky aktivitet do të duhet të paguajë mbrapsht patjetër një pjesë të të ardhurave të tij për kompensimin e dëmeve mjedisore e sociale që shkakton gjatë funksionimit të tij.¹³

Në rastin e Shqipërisë nuk kemi një instrument të tillë që vendos taksa që i shkojnë pushtetit vendor në kuadër të prodhimit energjistik nga hidrocentralet por kemi një instrument i cili i

¹⁰ OECD (2024), *Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania*, Competitiveness and Private Sector Development, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/541ec4e7-en>.

¹¹ Willige, A. (2024, August 22). *4 essential insights from China on financing the energy transition*. World Economic Forum. <https://www.weforum.org/stories/2024/08/china-green-financing-energy-transition/>

¹² Bian, L., Dikau, S., Miller, H., Pierfederici, R., Stern, N., & Ward, B. (2024, February). *China's role in accelerating the global energy transition through green supply chains and trade*. Grantham Research Institute on Climate Change and the Environment, London School of Economics and Political Science. <https://www.lse.ac.uk/granthaminstitute/wp-content/uploads/2024/02/Chinas-role-in-accelerating-the-global-energy-transition-through-green-supply-chains-and-trade.pdf>

¹³ European Union. (2024). *Hydropower*. European Commission. Retrieved November 19, 2024, from https://energy.ec.europa.eu/topics/renewable-energy/hydropower_en

shkon buxhetit të shtetit. Në këtë mënyrë sipas VKM nr. 822, datë 7.10.2015 “Për Miratimin e Rregulloreve dhe Procedurave të Ndërtimit të Kapaciteteve të Reja Prodhuese të Energjisë Elektrike” në nenin 18, kompanitë që operojnë në sektorin e prodhimit energjistik nga hidrocentralet i detyrohen shtetit shqiptarë jo më pak se 2% i sasisë vjetore të prodhimit ose konvertimin e saj në vlerë. Në rast konvertimi në vlerë monetare, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit.

Në këtë kontekst në pushtetin vendor nuk ka një tarifim të prodhimit energjistik nga hidrocentralet të cilët kanë efekt të pakthyeshem në territoret e bashkive dhe komunitetet e tyre. Një tarifë e tillë e bazuar në prodhimin e energjisë nga HEC-et do të ndihmonte bashkitë të plotësonin nevojat e tyre dhe impaktin në mjedis që ka egzistenca e këtyre hidrocentraleve apo dëmevë që shkaktojnë përmytjet nga shkarkimet e tyre.

Bashkia	Trupi Ujor	Vendodhja	Nr i HECeve	Sasia e prodhimit në Këh	Sasi Këh që i QQ (2%)	Vlera e të ardhurave nga taksa 2%/ HEC në Lek
Mirditë	FAN	Klos	1	5130000	102600	1026000
Pukë / Mirditë	FAN	Peshqesh Ura e Fanit Fangu	3	347246000	6944920	69449200
Mirditë	FAN	Bisak	1	3520000	70400	704000
Rrëshen / Burrel	MAT	Seke Zais	2	63760000	1275200	12752000
Mirditë	FAN	Zall Xhuxhe 1, Zall Xhuxhe 2	2	5577068	111541.36	1115413.6
Mirditë	FAN	Shengjon 1 Shengjon 2 Shengjon 3	3	5697200	113944	1139440
Mirditë	MAT	Blaç	1	3600012	72000.24	720002.4
Totali Bashkia Mirditë			13	434530280	8690605.6	86906056
Skrapar	OSUM	Vlushe	1	65000000	1300000	13000000
Skrapar	OSUM	Faqekuq 1 Faqekuq 2	2	18566000	371320	3713200
Skrapar	DEVOLL	Ujanik 2	1	9579419	191588.38	1915883.8
Skrapar	OSUM	Backa 1,C,A	3	17854610	357092.2	3570922
Skrapar	DEVOLL	Tomorric Dobrenj	1	3254000	65080	650800
Skrapar	OSUM	Vendresh	1	2879868	57597.36	575973.6
Totali Bashkia Skrapar			9	117133897	2342677.94	23426779.4

Tabela 2: Vlera e të ardhurave nga taksa 2%/ HEC në Lekë në Mirditë dhe Skrapar

Për të llogaritur vlerën e të ardhurave që vijnë nga kjo taksë për prodhimin e energjisë nga hidrocentralet, janë marr parasysh hidrocentralet e bashkive Mirditë dhe Skrapar. Konkretisht nga hidrocentralet, të cilët ndodhen në bashkitë Mirditë dhe Skrapar në buxhetin e shtetit shkojnë rreth 110.3 mln lekë (86.9 mln nga HEC-et në Mirditë dhe 23.4 mln lekë nga HEC-et në Skrapar).

Një instrument, i cili është i nevojshëm në Shqipëri dhe që mund të rrisë nivelin e autonomisë

vendore është taksimi i prodhimit energjitik të hidrocentraleve nga bashkitë. Një instrument i tillë financiar është i vendosur në nivel qendror nëpërmjet VKM nr. 822 datë 7.10.2015, ku 2% e prodhimit energjitik të hidrocentraleve i shkojnë në formën e “royalty” buxhetit të shtetit. **Instrumenti që propozohet është që 1% e prodhimit energjitik të veprave energjitike hidrike të shkojë në formë financiare pushtetit vendor**, e cila do të përdoret për shërbimet publike vendore ose për të zvogëluar impaktin mjedisor që kanë këto vepra inxhinierike në territor apo edhe për kompensimin e dëmeve të katastrofave natyrore si pasojë e këtyre veprave. Nëse marrim shembullin e Bashkive Skrapar dhe Mirëditë, në Bashkinë Skrapar ky instrument do të rriste buxhetin me **11.7 mln lekë apo me 1.7% të buxhetit bashkiak**, ndëkohë ky instrument do të rriste me **43.6 mln lekë ose me 5.1% buxhetin e Bashkisë Mirditë**. Një instrument i tillë do të ndihmonte bashkitë të zhvillojnë investime të tjera të shtuara në kuadër të nevojave të tyre apo të mbroheshin nga efekte financiare që vijnë nga pushteti qendror, siç është rritja nivelit të pagave me VKM 503 datë 1.8.2024, ku rritja e pagave bëhet nga të ardhurat e veta të bashkive në mes të vitit buxhetor. Kjo bëhet veçanërisht shumë e rëndësishme, kur bashki të vogla me kapacitetet financiare të kufizuara kanë norma shumë të larta të shpenzimeve operative në raport me buxhetin total.

Bashkitë Mirditë dhe Skrapar impakti financiar i rentës minerare si mundë të impaktojë rritja e kësaj rente

Bashkitë Mirëditë dhe Skrapar janë dy bashki të cilat kanë rezerva të shumta minerare ku respektivisht Bashkia Mirëditë zotëron në territorin e saj 129 burime minerare, por ka vetëm 15 leje minerare që do të thotë se rreth 10% e zonave minerare në bashki shkrytëzohen ku minerali kryesor është bakri. Bashkia Skrapar zotëron rreth 9 burime minerare që kryesisht kanë të bëjnë me materiale inerte (mermere), të cilët përdoren në sektorin e ndërtimit duke patur 18 leje minerare në bashki. Sa i përket llojit të mineraleve në AKBN nga subjektët që operojnë në këto territore raportohen se në bashkinë Mirëditë janë nxjerrë 143,200 ton bazalte, 950 ton krom dhe 185,438 ton bakër, ndërsa në Bashkinë Skrapar janë nxjerrë 9,700 m³ gur gëlqeror i mermerizuar, 6,482 m³ gur ranor silicor e ranor pllakor dhe 4,086 m³ gur gëlqeror.




Figura 2: Hartë gjeografike minerare e Bashkisë Mirëditë dhe Bashkisë Skrapar

Bashkia Mirëditë ka nën administrimin e saj katër qytete (Rrëshen, Rubik, Kurbnesh dhe Reps), 81 fshatra me një sipërfaqe totale prej 869.71 km² pjesë e qarkut të Lezhës dhe kufizohet nga bashkitë Fushë Arrëz, Pukë, Lezhë, Kurbin, Mat, Dibër dhe Kukës. Sipas Census-it të vitit 2011, bashkia numëron 22,103 banorë ndërkohë që sipas RGJC-së kjo bashki ka një popullsi prej 37,384 banorë, dhe densitet prej 43 banorë/km².

Sa i përket të ardhurave kjo bashki në vitin 2022 ka një total prej 848.02 mln lekë nga të cilat 798.1 mln lekë ose 94% të totalit të të ardhurave vijnë si trnsfertë ndërqeveritare ndërsa taksat e ndara nga trasferta ndërqeveritarë ku bën pjesë edhe renta minerarë zë vëtem 2.22% të totalit të të ardhurave.

Sipas natyrës ekonomike, rreth 90% e shpenzimeve shkoi për mbulimin e shpenzimeve korrente të bashkisë Mirditë: shpenzime personeli, operative dhe të tjera. Gjatë vitit 2022, kjo kategori shpenzimesh u zgjerua me rreth 7% në terma vjetorë. Investimet apo shpenzimet kapitale përfaqësuan rreth 10% të shpenzimeve totale në fund të vitit 2022. Shpenzimet kapitale rezultojnë jenë ulur me rreth 33% në terma vjetorë në fund të vitit 2022.

Bashkia Skrapar ka nën administrim një qytet dhe 106 fshatra me një sipërfaqe totale prej 831.44 km² pjesë e Qarkut Berat dhe kufizohet nga bashkitë Gramsh, Poliçan, Berat, Maliq, Korçë, Përmet, dhe Këlcyrë. Sipas Census-it të vitit 2011, bashkia numëron 12,403 banorë ndërkohë që sipas RGjC-së kjo bashki ka një popullsi prej 12,403 banorë, dhe densitet prej 23 banorë/km².

Në kuadër të të ardhurave totale kjo bashki ka rreth 674.1 mln lekë në vitin 2022 ndërkohë 595.8 mln lekë ose 88% vijnë si transfertë ndërqeveritare ndërsa taksat e ndara nga trasferta

ndërqeveritarë ku bën pjesë edhe renta minerarë zë vëtëm 1.29% të totalit të të ardhurave.

Sipas natyrës ekonomike, rreth 69% e shpenzimeve shkojnë për mbulimin e shpenzimeve korrente të bashkisë Skrapar (shpenzime personeli, operative dhe të tjera). Gjatë vitit 2022, kjo kategori shpenzimesh u zgjerua me rreth 7% në terma vjetorë. Investimet apo shpenzimet kapitale përfaqësuan rreth 31% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2022. Në terma sasiorë, shpenzimet kapitale regjistruan një nivel prej rreth 201 milionë lekë në vitin 2022, në rënie vjetore me rreth 9%.

Nga të dhënat që disponon Ministria e Financave për transfertat minerare në këto dy bashki vërehen se transfertat janë të papërfillshme më konkretisht në Bashkinë Mirditë në vitin 2023 kemi vetëm 20000 lekë ose 0.013% të transfertës kombëtare ndërsa në Bashkinë Skrapar kemi 16310 lekë ose 0.01% të transfertës.

Njësitë vendore	Renta Minerare, Shuma në lekë						
	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Korrik 2024
Bashkia Mirditë	25,824	2,143	0	0	0	20,040	0
	0.014%	0.001%	0.000%	0.000%	0.000%	0.013%	0.000%
Bashkia Skrapar	120,558	198,898	28,704	29,222	20,036	16,310	0
	0.065%	0.109%	0.026%	0.019%	0.009%	0.010%	0.000%
Total	186,740,826	181,866,492	112,125,437	152,097,648	234,881,404	157,938,859	24,678,300

Tabela 3: Renta Minerare në Lekë për Bashkitë Mirditë dhe Skrapar

Kjo gjendje ka disa shkaqe ku shkaku i parë është shkak ligjor që në vitin 2021 qeveria miratoi ligjin nr. 151/2020 Për ndryshime në Ligjin nr 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar ku renta minerare për kompanitë që operojnë në industrinë nxjerrëse metalore në zona rurale të lirohen nga pagesa e rentës deri në vitin 2024. Kjo ka sjellë që në bashki rurale ku insdutria nxjerrëse përbehet nga meneralet metalore siç është rasti i Mirditës pothuajse të zerohet. Ndërkohe shkaqet e tjera janë shkaqe të natyrës proceduariale në nivel koordinimi ndërinstytucional gjë e cila sjell që të ardhurat nga renta të jenë në nivele shumë të ulëta.

Normat kaq të ulëta të rentës vijnë si pasojë e procesit burokratik të vjeljes së kësaj të ardhure, e cila hyn në një proces mjaft të komplikuar ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore, drejtorisë së buxhetit në Ministrinë e Financave, drejtorive doganore dhe drejtorive rajonale tatimore, i cili paraqitet me nivel të ulët koordinimi ndërinstytucional. Po ashtu, në këtë proces të vjeljes së kësaj të ardhure, bashkitë nuk kanë rol monitorues në aktivitetin minerar si institucione, të cilat janë të interesuara në rritjen e të ardhurave por edhe në impaktin mjedisor që kanë këto aktivitete industriale në territoret e tyre.

Nga analizat e vendeve të rajonit si dhe nga parabazitë ekonomike e territoriale të paraqitura më sipër, për Shqipërinë do të ishte e rekomandueshme që të kishim një sistem të derivuar. Bashki me zhvillim socio-ekonomik mbi mesataren e indikatorëve kombëtar dhe bashki me zhvillim socio-ekonomik nën mesataren e indikatorëve kombëtar. Për të patur një efekt të qënësishëm në rritjen

e barazisë rajonale, diferenca mes fashave të transfertave duhet të jetë evidente e cila rekomandohet 15% e rentës kombëtare për prodhimin mineral në territoret e bashkive me zhvillim socio-ekonomik mbi mesataren kombëtare dhe 35% e rentës kombëtare për prodhimin mineral në territoret e bashkive me zhvillim socio-ekonomik nën mesataren kombëtare.

Në këtë skenar, me një vlerësim të përafërt të situatës dhe indikatorëve bashkiak në bazë të performancës ekonomike rreth 20 bashki përfshihen në grupin e rentës 15% dhe rreth 41 përfshihen në grupin e rentës 35%. Sipas Ministrisë së Financave në vitin 2022, renta minerare që i transferohej bashkive ishte në **vlerën 234 mln lekë** si vlera më e lartë në 6 vitet e fundit, me skenarin e propozuar kjo vlerë **do të 6 fishohej dhe do të shkonte në vlerën e 1.447 miliard lekë**, nga një ndarje proporcionale e dy grupeve të bashkive sipas transfertës së rentës 15% dhe 35%. **Bashkia Skrapar dhe Bashkia Mirëditë do të përfitonin përkatësisht nga 29.2 mln lekë** vetëm nga renta minerare, duke mos përlogaritur këtu masat për monitorimin e prodhimit mineral të cilat do të rrisnin transfertën e rentës më shumë. Duke marrë parasysh edhe propozimin e instrumentit të “royalty” ku 1% e prodhimit energjitik të hidrocentraleve i shkon bashkive në total për të dy bashkitë, **kjo vlerë do të arrinte në 113.7 mln lekë ku 72.8 mln lekë i shtohen buxhetit të Bashkisë Mirditë dhe 40.9 mln lekë i shtohen buxhetit të Bashkisë Skrapar.** Në këtë kontekst për Bashkinë Mirëditë kjo do të ndikonte në rritjen e buxhetit me 8.5 % dhe rritjen e investimeve kapitale me 85%, ndërkohë për Bashkinë Skrapar kjo do të rriste buxhetin me 6.09% si dhe investimet kapitale me 26.5% gjë që do të rriste mundësitë për investime për përmirësimin e shërbimeve publike.

Rekomandimet

Ndërtimi i një instrumenti të ri për transferimin e të ardhurave nga industria nxjerrëse dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore nga pushteti qendror në atë vendor është një instrument që rrit në mënyrë të qënësishme autonominë vendore, duke rritur pavarsinë e pushtetit vendor kundrejt qendrorit dhe duke i lënë mundësinë që të plotësojë nevojat e komunitetit në zonë. Në thelb ky instrument, lë mundësi për rritjen e performancës së pushtetit vendor në tërësi duke përforcuar zbatimin dhe thelluar më tej reformën administrative-territoriale në Shqipëri, e cila ka hasur jo pak vështirësi në zbatimin e saj në dekadën e parë.

Një nga mësimet më kryesore të nxjerra nga përvojat globale është nevoja për të balancuar interesat e rajoneve prodhuese të burimeve me ato të rajoneve joprodhuese. Në shumë raste, rajonet ku bëhet nxjerrja mbajnë peshën më të madhe të kostove mjedisore, sociale dhe ekonomike, të tilla si ndotja, zhvendosja dhe dëmtimi i burimeve lokale. Prandaj, është thelbësore që këto rajone të marrin një pjesë të drejtë të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja e burimeve për të kompensuar ndikimet lokale.

Për Shqipërinë, futja e një sistemi të ndarjes së të ardhurave të burimeve natyrore do të ishte veçanërisht e rëndësishme në trajtimin e pabarazive rajonale. Shumë nga zonat e pasura me burime të vendit, veçanërisht ato të përfshira në miniera, janë ndër më të pafavorizuarat ekonomikisht dhe më të ndikuara nga mjedisi. Duke siguruar që një pjesë e të ardhurave nga industria nxjerrëse minerale të kthehen në këto qeveri lokale. Shqipëria mund t'i fuqizojë këto rajone për të investuar

në zhvillimin e tyre, për të zvogëluar varfërinë dhe për të ndërtuar fleksibilitet kundër dëmit mjedisor të shkaktuar nga aktivitetet e nxjerrjes. Kjo jo vetëm që do të përmirësojë kushtet e jetesës në rajonet e pasura me burime, por gjithashtu do të kontribuonte në qëllime më të gjera kombëtare të zhvillimit **gjithpërfshirës dhe të qëndrueshëm**.¹⁴ Adoptimi i një sistemi të bazuar në tregues, mund të ndihmojë në sigurimin që, rajonet e pazhvilluara të përfitojnë nga pasuria minerare e vendit, edhe nëse ato nuk janë të përfshira drejtpërdrejt në industrinë nxjerrëse. Duke përfshirë tregues të tillë si niveli i varfërisë, madhësia e popullsisë dhe nevojat e infrastrukturës në formulën e ndarjes së të ardhurave, Shqipëria mund të synojë burimet për fushat që kanë më shumë nevojë për to, duke nxitur zhvillimin më të balancuar kombëtar.

Në mënyrë që ky instrument ti shërbejë edhe rritjes së autonomisë vendore, por edhe një instrument për të ulur pabarazitë rajonale rekomandohet që Shqipëria të ketë një sistem të derivuar në bazë të indikatorëve për rentën minerare duke u bazuar në indikatorë ekonomikë apo social që kanë të bëjnë me papunësinë, varfërinë apo nivelin ekonomik. Në këtë kuadër propozohet që të ketë **dy grupe bashkish**: bashki të cilat në bazë të indikatorëve kanë nivel ekonomik dhe social më të lartë në të cilat do të propozohet 15% e të ardhurave nga taksat e aktivitetit minerar, bashkitë që kanë nivel ekonomik dhe social të ulët për të cilat propozohet 35% e të ardhurave nga taksat e aktivitetit minerar me qëllim që të kontribuojë në uljen e pabarazive rajonale ndërmjet bashkive. Ky instrument ndërmerr anulimin e ligjit nr. 151/2020, për një ndryshim në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar i cili lironte nga taksat kompanitë operuese në zonat rurale në sektorin e industrisë nxjerrëse metalore. Nga një vlerësim i përafërt në bazë të performancës ekonomike dhe sociale të bashkive, kemi 20 bashki të cilat hyjnë në grupin e aplikimit të rentës me 15% dhe kemi 41 të cilat përfshihen në grupin e rentës 35%. Në bazë të të dhënave nga Ministria e Financave duke marrë parasysh vitin 2022 ku transferta kombëtare e rentës vlerësohej me 234 mln lekë me aplikimin e skemës së re të mësipërme kjo transfertë do të rritej me më shumë se 6 herë dhe vlerësohet në rreth 1.447 mld lekë. Ky instrument do të nxiste rritjen e shpenzimeve vendore në raport me shpenzimet e përgjithshme publike dhe atë të shpenzimeve vendore ndaj PBB idikatorë që Shqipëria i ka dukshëm më të ulët sesa vendet e BE. Vlerësuar kjo në nivelin e bashkive në studim (Mirëditë dhe Skrapar) si dhe duke shtuar dhe instrumentin mbi taksimin e prodhimit energjitik në bashki transfertat minerare për këto dy bashki rriten me 113.7 mln lekë (72.8 mln lekë për Bashkinë Mirditë dhe 40.9 mln lekë për Bashkinë Skrapar). **Nga ky skenar Bashkia Mirëditë do të kishte një rritje mesatare prej 8.5% të buxhetit ndërsa Bashkia Skrapar do të kishte një rritje prej 6% të buxhetit.**

Ndërtimi i mekanizmit të monitorimit të përbashkët institucional të veprimarisë së industrisë nxjerrëse dhe industrisë energjitike si një mënyrë që garanton respektimin e procedurave ligjore apo detyrimeve financiare. Ky hap është shumë i rëndësishëm, veçanarisht në bashki të cilat kanë sasi të mëdha të prodhimit të mineraleve, të cilat duhet të jenë në proporcion me detyrimet e rentës minerare që i vijnë bashkive. Në rastin e bashkisë Mirëditë kemi të deklaruar rreth 143,200 ton

¹⁴ UNECE JUST TRANSITION ASSESSMENT OF ALBANIA Sector Decarbonization and the Just Transition Framework Applied to Coal Mining - <https://unece.org/sites/default/files/2024-04/UNECE%20ALBANIA%20Just%20Transition%20And%20Decarbonization%20Report%20FINAL.pdf>

bazalte, 950 ton krom dhe 185,438 ton bakër dhe janë paguar vetëm 20,000 lekë rentë minerare. Me këtë rast edhe sistemi i transferimit të rentës duhet të jetë fleksibël dhe i thjeshtë në aplikimin e tij. Industria nxjerrëse duke qënë një sektor, i cili ka një potencial të lartë ekonomik dhe nga ana tjetër ka efekte të mëdha në mjedis, do të duhet të propozohen masa konkrete për minimizimin dhe zbutjen e efekteve negative në mjedis me anë të një plani veprimi ku masat mjedisore të implementohen nga kompania operative dhe të monitorohen nga pushteti vendor për ndërmarrjen e këtyre masave.

Me rritjen e autonomisë vendore dhe fiskale bashkitë do të kënë në dispozicion buxhete më të larta për të menaxhuar e në këtë mënyrë edhe përgjegjësia do të jetë më e lartë. Në këtë kontekst bashkive u lind nevoja të rrisin kapacitetet njerëzore dhe menaxhuese. Në këtë mënyrë sigurohen që autoritetet lokale të mund të menaxhojnë në mënyrë efektive fluksin e të ardhurave të burimeve duke i pajisur zyrtarët lokalë me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme.

Referencat

- Bian, L., Dikau, S., Miller, H., Pierfederici, R., Stern, N., & Èard, B. (2024, February). China's role in accelerating the global energy transition through green supply chains and trade. Grantham Research Institute on Climate Change and the Environment, London School of Economics and Political Science. <https://www.lse.ac.uk/granthaminstitute/Wp-content/uploads/2024/02/Chinas-role-in-accelerating-the-global-energy-transition-through-green-supply-chains-and-trade.pdf>
- Bradford, D. F., & Oates, È. E. (1971). Analiza e ndarjes së të ardhurave në një qasje të re ndaj vendimeve fiskale kolektive. *Gazeta Tremujore e Ekonomisë*, 85(3), 416–439. <https://doi.org/10.2307/1885931>
- Copithorne, L., MacFadyen, A., & Bell, B. (1985). Ndarja e të ardhurave dhe vlerësimi efikas i burimeve natyrore. *Canadian Public Policy / Analyse de Politiques*, 11, 465–478. <https://doi.org/10.2307/3551076>
- European Union. (2024). Hydropoëer. European Commission. Retrieved November 19, 2024, from https://energy.ec.europa.eu/topics/reneëable-energy/hydropoëer_en
- Fedelino, A. (2010). Making fiscal decentralization ëork: Cross-country experiences - Indonesia. International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781589069855.084>
- Keuffer, N. (2016, July). *Local autonomy, a multifaceted concept: Hoë to define it, hoë to measure it, and hoë to create a comparative local autonomy index?* Paper presented at the International Congress of the International Political Science Association (IPSA),

- Poznań, Poland. Retrieved from https://www.researchgate.net/publication/331194391_Local_Autonomy_a_Multifaceted_Concept_How_to_define_it_How_to_Measure_it_and_How_to_Create_a_Comparative_Local_Autonomy_Index
- Narh, J. (2023). Mallkimi i burimeve dhe roli i institucioneve. *Environ Dev Sustain*. <https://doi.org/10.1007/s10668-023-04279-6>
- National Resource Governance Institute. (2016, September). Natural resource revenue sharing. Local2030. Retrieved November 19, 2024, from <https://www.local2030.org/library/221/Natural-Resource-Revenue-Sharing.pdf>
- OECD. (2024). Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania. Competitiveness and Private Sector Development. OECD Publishing, Paris. <https://doi.org/10.1787/541ec4e7-en>
- Okpaleke, F. N., & Abraham-Dukuma, M. (2020). Dynamics of resource governance, climate change and security: Insights from Nigeria and Norëay. *Journal of Strategic Security*, 13(4), 123-140. <https://www.jstor.org/stable/26965522>
- UNECE. (2024, April). Just Transition Assessment of Albania: Sector decarbonization and the just transition framework applied to coal mining. Retrieved November 19, 2024, from <https://unece.org/sites/default/files/2024-04/UNECE%20ALBANIA%20Just%20Transition%20And%20Decarbonization%20Report%20FINAL.pdf>
- Velenturf, A. P. M., & Purnell, P. (2021). Principles for a sustainable circular economy. *Sustainable Production and Consumption*, 27, 1437–1457. <https://doi.org/10.1016/j.spc.2021.02.018>
- Willige, A. (2024, August 22). 4 essential insights from China on financing the energy transition. World Economic Forum. <https://www.weforum.org/stories/2024/08/china-green-financing-energy-transition/>